

data 24.03.2025

TERMAT E REFERENCES

Kompani për "Krijimin e programit për bazën e të dhënave të fëmijëve të komunitetit"

Organizata	OJQ "NEVO KONCEPTI
Objektiva	Krijimi i programit për bazën e të dhënave të fëmijëve të komuniteti (Data Bazë).

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga viti 2022 të muajit Qershor ka filluar të zbatojë projektin "Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve" në Komunën e Prizrenit, asambleja përbëhet nga 45 antarë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat e komunës së Prizrenit. Në Asamblenë Komunale të Fëmijëve janë të përfshirë komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian, gjithashtu në Asamblenë Komunale të Fëmijëve përfaqësohen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat organizohen nga Asambleja Komunale e Fëmijëve.

Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 2 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

"Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve" është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulta të komunës së Prizrenit.

3. OBJEKTIVA

Zhvillimi i një baze të dhënash të sigurt dhe të personalizuar për fëmijët dhe përfituesit e projekteve në kuadër të organizatës Nevo Koncepti, e cila mundëson menaxhimin e informacionit në mënyrë efikase dhe të mbrojtur, duke siguruar qasje të lehtë për menaxherët dhe personat të cilët do të autorizohen nga Drejtori i Organizatës, të cilët mbështesin fëmijët dhe ofrojnë shërbime. Kompania që do të angazhohet do të krijojë një platformë të besueshme dhe të avancuar për ruajtjen dhe analizën e të dhënave të fëmijëve, me focus në sigurinë dhe privatësinë e informacionit.

QJQ Nevo Koncepti është duke kërkuar një kompani profesionale, e cila do të zhvillojë dhe implementojë një program softuerik bazuar në SQL për ruajtjen e të dhënave të përfituesve në kuadër të projekteve të organizatës Nevo Koncepti, duke siguruar akses të lehtë, siguri të lartë dhe efikasitet në krijimin e programit.

profesionale e cila do të krijojë një programit për bazën e të dhënave të fëmijëve të komuniteti

4. AFATI KOHOR

Puna duhet të filloj nga 31 Mars deri me 17 Prill 2025.

5. REZULTATET E PRITSHME

- Zhvillimi i një baze të dhënash të strukturuar dhe të sigurt.
- Siguria e të dhënave.
- Përdorueshmëria e lehtë (Të krijohet një ndërfaqe miqësore për menaxhimin e qasjen e të dhënave nga përdoruesit e autorizuar).
- Skalueshmëria – Sistemi i krijuar i ndërtuar në mënyrë që të mund të zgjerohet lehtësishtë për të mbuluar një numër më të madh të përfituesve në të ardhmen)
- Qasja e personalizuar për përdoruesit.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen duke përfshirë këto dokumente:

- Kuptimi i detyrës dhe nëndetyrave të saj;
- Metodologjia dhe qasja që do të përdoret;
- Propozimi financiar për çdo ditë pune duke përfshirë një ofertë në shumën pa TVSH (kompani) dhe shumën bruto (individuale) përpara çdo zbritjeje ligjore të vendit të origjinës;
- Curriculum Vitae (për individë);
- Certifikata e biznesit dhe referencat (për kompanitë).

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 28.03.2025 në ora 16:30** në

prokurimi@nevokoncepti.org